



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 48, Datë 24.03.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SOLARIS POWER”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR
NJË AFAT 5-VJEÇAR.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10 pika 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.03.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 447 Prot, datë 17.02.2020, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 13.06.2019, konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
- Objekt të veprimtarisë së saj shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., sh.p.k ka tregtimin e energjisë.
- Aplikimi i shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht;
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8; gërmat “a”, “b”, “c”, “d”,) është plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- Format i aplikimit sipas kërkesave të pikës “a”, “b” dhe “c” të këtij neni është plotësuar pjesërisht.
- gërma “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit)
Përsa i takon përfaqësuesit ligjor, shoqëria ka përcjellë në ERE prokurën e posaçme në formatin fotokopje, ndaj do t’i kërkohej që të sjellë këtë akt përfaqësimi sipas formës së përcaktuar në nenin 8, pika 3, të rregullores së licencimit.

Neni 9, pika 2, Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- gërma “d” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria)
Në aplikimin e bërë nga shoqëria mungon vërtetimi i prokurorisë për administratorin e shoqërisë, si dhe vërtetimet gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin ligjor. Ky dokumentacion do t’i kërkohej shoqërisë të depozitohet në ERE jo me vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjëndjes së epidemisë së shkatuar nga Covid 19.
- gërma “e” (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse)
Shoqëria nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores dhe do t’i kërkohej plotësimi i këtij dokumentacioni.

Neni 9, pika 3: Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- gërma “c” (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit)
Shoqëria nuk ka përcjellë dokumentacion që vërteton aftësinë ose mbështetjen financiare të tij për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Do t’i kërkohej shoqërisë të depozitohet në ERE dokumentacionin përkatës.

Neni 9, pika 4.8, Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike

- gërma “a”. Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh sipas viteve;
Shoqëria nuk ka paraqitur parashikime të tilla, ndaj do t’i kërkohej të depozitohet këtë informacion në ERE.

- germa “b”. Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vertetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj. Shoqëria nuk ka paraqitur të dhëna në lidhje me kapitalin financiar, ndaj do t’i kërkohet të paraqesë në ERE dokumentacionin e nevojshëm për këtë kërkesë të rregullores.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, e ndryshuar, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Subjekti aplikues ka detyrimin për të paraqitur jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid 19 vertetimet e percaktuara në nenin 9 germa d të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 215/2019.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI